



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 17.

Prishtinë, më 27.09.2011 në ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-203

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Elmi Reçica, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Agim Kuleta, Jasmina Živkovic, Jelena Bontic, Mufera Sinik, Rasim Demiri dhe Etem Arifi.

Mungon: Petar Miletic

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësues të OSB-ja Lejla Selimi, përfaqësuesit nga KDI-Besnik Ramadani, përfaqësuesi i KKK-Veton Berisha, përfaqësuesi nga Presidenca-Ukë Gashi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: Natasa Prica-Tisma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Goran Marinkovic, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Takim me ministrin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal -Slobodan Petrovic, lidhur me implementimin e Ligjit nr. 03/L- 047 për Mbrojtjen dhe promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.**

Goran Marinkovic -tha se për këtë takim Komisioni për komunitete dhe Kthim ka ftuar ministrin e Ministrisë së Administratës të Pushtetit Lokal Slobodan Petrovic, që të ofrojë sqarime konkrete lidhur me zbatimin e ligjit nr. 03/L- 047 për Mbrojtjen dhe promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, në nivel Komunal të Republikës së Kosovës.

Slobodan Petrovic- në fjalinë e tij tha se ky komision ka rol të rëndësishëm në Parlament, jo vetëm në miratimin e ligjeve por edhe në implementimin e tyre në praktik, ofron përkrahje të drejtave të komuniteteve që janë në interes të të gjithë qytetarët të cilët jetojnë në Kosovë.

Ai prezantoi disa çështje aktuale me të cilat Ministria e Pushtetit Lokal i ushtron në përmirësimin e të drejtave të njeriut.

Në Kosovë ka një spektër të gjerë të ligjeve, duke filluar nga Kushtetua, ku nga kapitulli 21 deri në kapitullin 56 vëmendje të veçantë u kushtohet fushës së të drejtave të njeriut, siç janë Ligji për përdorimin e Gjuhëve, Ligji Kundër Diskriminimit, Ligji për të Drejtat e Njeriut, Ligji për Barazi Gjinore, etj,

MAPL, në vazhdimësi ka aktivitete në përmirësimin e të drejtave të njeriut, ka nxjerr udhëzimin Administrativ nr. 2007/06 i plotësuar me U.A, 2008/02 dhe i njëjti i ndryshuar me U.A 2011/01. Në bazë të këtyre U.A janë themeluar 34 njësi Komunale për të Drejtat e Njeriut, në 34 komuna, ku ushtrohet promovimi i të drejtave të tyre në nivel lokal.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton pjesëmarrje aktive në vendimmarrje politike, me anë të përfaqësimit në të gjitha organet shtetërore

Sipas të dhënave nga komunat, nuk ka shkelje të drejtave të komuniteteve, gjithashtu në procesin e rekrutimit të stafit nuk ka shkelje të aplikantëve.

Pasi ende nuk kemi të regjistër me të dhëna për regjistrimin e qytetarëve të republikës së Kosovës të cilët punojnë dhe jetojnë momentalisht në diasporë, andaj nuk kemi pasqyrë të saktë nëse përfaqësimi i komuniteteve në administratë reflekton komfor legjislationit.

Sa i përket trashëgimisë kulturore, fetare dhe monumenteve të trashëgimisë shtetërore, ato janë të mbrojtura me legjislationin në fuqi. Kështu që shumica e komunave si Vushtrria, Vitia, Shtimja, kanë hartuar Planin zhvillimor për adresimin e objekteve trashëgimore, kurse komunat tjera këto plane i kanë përfshirë në Planin zhvillimor të Komunës.

Komunitetet kanë qasje të barabarta për informim në gjuhën e tyre. Pjesëtarët e komuniteteve gëzojnë të drejtën në arsimimit në gjuhën e tyre e cila ju është garantuar me Kushtetutë.

Janë të identifikuar familjet që jetojnë në kushte të rënda banimi. Në Gjakovë, Pejë, Prishtinë ka qendra për banim social.

Komuna ka projekte ku komunitetet fitojnë strehim, siç është komuna e Mitrovicës e cila ka realizuar 3 projekte ku janë strehuar 214 familje me 1020 anëtar. Gjakova deri tani ka realizuar 6 projekte dhe se për vitin e ardhshëm parasheh edhe 4 projekte të reja. Gjithashtu me qëllim të strehimit të familjarëve të komuniteteve që jetojnë në territorin e komunës janë qytetet Gjilani, Klina, Peja, Vushtrria

Të gjitha komunat kanë hartuar planin strategjik për kthim, e cila zbatohet varësisht nga mundësit financiare për krijimin e kushteve.

Të gjitha komunat kanë bërë fushata, përmes mediave lokale, takimeve, emisioneve, shpërndarjes së informuesve për regjistrim për personat që kthehen.

Aktivitet tjetër i MAPL është se ka nxjerr Udhëzime Administrative për procedurë për zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve nr.2011/02.

Sa i përket përdorimit të gjuhëve 30 komuna i kanë miratuar rregulloret komunale ndërsa komunat të cilat nuk i zbatojnë këto rregullore e të cilët nuk është e thanën që nuk i respektojnë përdorimin e dy gjuhëve janë, Malisheva, Partesh dhe Graqnica,

Si gjuhë boshnjake në përdorim zyrtar përdoret në komunën e Prishtinës, Pejës dhe Gjilanit.

Sipas kërkesës së palëve, Institucionet dhe organet komunale ofrojnë shërbime dhe dokumente publike në gjuhën zyrtare.

Funksionon njësia e përkthimit në 27 komuna. Komunat të cilat nuk kanë njësi përkthimi janë. Malisheva, Hani i Elezit, Drenasi, Parteshi, Klllokoti, Ranillugu, dhe Graqnica,

Sa i përket pushtetin qendror dhe ai lokal, nuk pengohet komunikimi në gjuhën amtare.

Është meritë e të gjitha Institucioneve se procesi i decentralizimit i cili është proces i planit të Atisarit është i vlerësuar me notën më të lartë nga Bashkësia Evropiane.

Albert kinolli shprehu mendimin e tij se pjesërisht pajtohet me të dhënat e cekura në raportin e ministrisë, kur është fjala për gjuhën e komunitetit rom.

Ai kërkoi sqarime nga ministri lidhur me këto pika.

Sipas kushtetutës të Republikës së Kosovës, neni 5-.ku thuhet se gjuha shqipe dhe gjuha serbe janë në përdorim si gjuhë zyrtare, ndërsa gjuha turke, boshnjake dhe aj rome janë në përdorim si gjuhë zyrtare në nivel Komunal. Edhe pse nuk është plotësuar kushti elementar prej 5 %, në bazë të Ligjit për përdorimin e gjuhëve zyrtare në nenin 4.2, thuhet se gjuha e cila është tradicionale që përdoret në një komunë mund të jetë në përdorim zyrtar. Komuniteti rom daton që 600 vite në këto treva, pra kushti ekziston që të përdoret gjuha rome si gjuhë zyrtare ndërsa deri sot kjo nuk është arritur.

Ai kërkoi sqarim nga ministri lidhur me zbatimin në praktikë të neneve të cekura më lartë pra cilat janë hapat konkret që ministria do të ndërmerren në të ardhmen.

Sa i përket përfaqësimit për punësim në Institucionet Publike, edhe pse me nenin 61 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, komuniteteve ua garantohet përfaqësimi i barabartë në të gjitha nivelet, e sidomos në Komunat ku së paku 10 % të banorëve u përket komuniteteve ndërsa gjendja në terren e tregon të kundërtën.

Ai shtroi pyetjen se si mund të kontribuojë komuniteti rome, çka do të ndërmerret në këtë drejtim, kur do të përmirësohen të drejtat e komunitetit tonë për të qen të barabartë me komunitetet tjera siç është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Slobodan Petrovic- theksoi se duhet të respektojmë dhe të veprojmë në bazë të Kushtetutës. Në bazë të kushtetutshmërisë gjuhë zyrtare janë gjuha shqipe dhe serbe ndërsa si gjuhë e dytë në numër, do të kenë mundësi të përdoren si gjuhë tradicionale.

Gjithashtu tha se Qeveria do ti mbron të gjithë qytetarët që jetojnë në Kosovë dhe se asnjë qytetar nuk do të jetë i diskriminuar nga shoqëria kosovare.

Si pritet është që të përfundohen procedurat e regjistrimit të popullsisë dhe në bazë të rezultateve zyrtare dhe në bazë të përmbushjes së kushtit elementar do përdoret gjuha e cila flitet.

Besim Osmani - Sipas shënimeve statistikore në komunën e Prizrenit përdoren si gjuhë zyrtare siç është gjuha e komunitetit turk dhe boshnjak Mirëpo kjo çështje do të ndryshon nëse formohet komuna e Reqanit ku do të kenë mundësi të aplikojnë edhe përfaqësuesit rome në përdorim të gjuhës së tyre.

Në këtë legjislacion ekzistojnë dy U.A të cilat janë të nënshkruara nga ministri, për promovimin e gjuhëve tradicionale dhe se lidhur me këtë çështje janë të informuara edhe komunat.

Gjatë monitorimi që ka bërë ministria jonë, nuk ka evidencë se është bërë që gjuha rome të përdoret si gjuhë tradicionale në komunën e Prizrenit.

Hetem Arifi- në fjalinë e tij tha se në Raportin e progresit të Komisionit Evropian është konstatuar se ka shkelje të të drejtave të komuniteteve.

Ka vërejtje në rregulloren 2/10 në bazë të së cilës janë krijuar zyrat komunale për komunitete dhe kthim, por ato nuk janë funksionale kur është fjala për pjesëtarët e komunitetit ashkali. siç i parasheh rregullorja në fuqi Ai paraqiti disa raste të kthimit të pjesëtarëve të komunitetit ashkali nga diaspora dhe se ata nuk trajtohen siç i parasheh Ligji.

Në këtë raport nuk janë të përshkruar kërkesat apo ankesat e komuniteteve pakicë, Është rasti i paraqitjes së ankesës në komunën e Lipjanit, zëvendës kryesuesi i kuvendit komunal nuk është i zgjedhur nga komunitet pakicë por është pjesëtar i komunitetit shqiptar.

Kishte vërejtje lidhur me mos realizimin e projektit për komunitetet të cilët fitojnë strehim. Ai parashtroj pyetje për ministrin se çka ka ndërmarr MAPL për komunitetin ashkali dhe romë në komunën e Obiliqit, ku shumë përfaqësues të këtyre komuniteteve ende jetojnë në tenda.

Besim Osmani- theksoi se në komunën e Lipjanit nuk ka përfaqësues të komunisteve të cilat kalojnë pragun prej 10 % në mënyrë që të fitojnë të drejtën e zgjedhjes si zëvendëskryesuesit . Kjo çështje është e rregulluar me Ligji për Vetëqeverisje Lokale.

Zëvendëskryesuesit nuk marrin pagë me legjislacion, marrin vetëm kompensim gjatë aktiviteteve të tyre në seanca si deputetët tjerë por me një përqindje më të lartë për pozitën si zëvendëskryesues.

Theksoi se është nënkryetar i bordit ekzekutiv për riatdhesim. Sa i përket komunitetit ashkali është problem i përbashkët sepse nuk ka evidenca të sakta se cilët komunitete janë kthyer. Ne duhet të identifikojmë shënimet individuale për riatdhesimin e secilit komunitet.

Mendon se për këtë çështje duhet të angazhohen të gjitha institucionet.

Dhe në fund çështja rreth djegies së objektit kolektiv në komunën e Obiliqit, shtoi se MKK udhëheq grupin punues ku në këtë grup ka përfaqësues nga ministria jonë Në këto takime ka pas përpjekje të shumta që të gjendet një zgjedhje adekuate. Gjithashtu, MAPL ka shpreh gatishmërinë e saj që të ofroj kontributin financiar, edhe pse ky obligim i takon MPMS.

Goran Marinkovic – kërkoi që në këtë takim të përqendrohem ekskluzivisht në temën rreth implementimit të Ligjit nr. 03/L- 047 për Mbrojtjen dhe promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, të marrim opinione nga ministri lidhur me integrimin e komunitetit malazez dhe atij kroat, të cilët i parasheh vet ndryshimi i projektligjit.

Lumnije Morina – ajo përkrah propozimin e kryetarit se Projektligji është hartuar me qëllim të definimit adekuat të komunitetit malazez dhe atij kroat si komunitete të cilët jetojnë në territorin e Kosovës.

Me theks të veçantë tha se ka dhënë dy propozim amendamente dhe se të njëjtat i ka paraqit para komisionit Dha sqarim se me miratimin e këtyre amendamenteve do të hiqen dilemat e përfaqësimit të komunitetit kroat dhe atij malazez.

Lidhur me integrimin e këtyre dy komuniteteve ajo kërkoi sqarim nga ministri, që komisioni të miratojë Projektligjin apo të pres deri në miratimin e ndryshimeve Kushtetuese.

Për sa i përket informave, zyra Komunale për komunitete nuk funksionon në komunën e Graçanic, Kaçanik, Hani i Elezit, Mamush., pyetja për ministrin rrjedh se çka ka ndërmarr ministria juaj që këto zyra të jen funksionale.

Dhe nën tre, në bazë të informatës së juaj në komunat e cekura njësit e përkthimit nuk funksionon, pra çka ka ndërmarr ministria që këto zyra të jenë funksionale.

Slobodan Petrovic –mendon se mirë është të priten të bëhen ndryshimet kushtetuese e cila është marrëveshje e përbashkët e Qeverisë.

Theksoi se ministria është në përgjegjësi të plot në përmbushjen e standardeve të qytetarëve në Kuvendet Komunale.

Sa i përket komunave të cilat kanë probleme me përkthim, kjo është çështje teknike.

Siç kemi rastin, në muajin e kaluar MAPL ka siguruar pajisjet për përkthim simulant sepse ka nevojë për përkrahje të resurseve humane të përkthyesve. Kjo është forma e cila po bëhet që të përmirësohet cilësia e përkthimeve në Kuvendet komunale.

Problemet ekzistuese janë se në komuna ende nuk ka përfunduar procesi i regjistrimit të popullsisë.

Rasim Demiri – kërkoi informatë nga ministri lidhur me çështjen se deri ku ka arritur kërkesa e komunitetit boshnjak në formimin e Komunës së Reçanit

Slobodan Petrovic- tha se MAPL ka mbajtur takime me deputetët e kuvendit Komunal për t'ju ndihmuar komunitetit tuaj, për të pasur jetë më të mirë dhe funksionale. Lidhur me këtë problematikë është informuar edhe Qeveria dhe Institucionet ndërkombëtare. Faza e parë është që të kemi raportin përfundimtar të regjistrimit të popullsisë, e cila është bazë për të gjitha aktivitetet e kuvendeve Komunale.

Lirije Kajtazi – Ajo tha se në fillim të muajit shtator është mbajtur konferenca rajonale me Ministrat e Pushtetit Lokal. Lidhur me këtë çështje parashtrij pyetje, sa respektohen të drejtat e komuniteteve në shtetet e rajonit, kur dihet se kemi strukturë nacionale të përzier. Sa janë bërë matje të respektimit të drejtave të komuniteteve dhe sa është arritur progresi i tyre në shtetet rajonale.

Slobodan Petrovic – në këtë Konferencë kanë marrë pjesë një numër i madh të shteteve dhe se janë ndarë përvojat të përbashkëta. Ajo që është inkurajuese për shoqërinë Kosovare është se punohet në masë të duhur në implementimin e ligjeve dhe se rritet avancimi në të gjitha lëmit për komunitet të cilët jetojnë në territorin e Kosovës.

Kryesuesi - falënderojë pjesëmarrjen e ministrit së bashku me stafin përcjellës duke shtuar se puna në komision do jetë më produktive në gjetjen e zgjidhjes së çështjes të komunitetit malazez dhe atij kroat.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00

Përgatitur nga:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinkovic